



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267102

Datë: 10.11.2020

Numri i dokumentit: 01259753

A.nr.1707/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Vjollca Limani, procesmbajtësen/zyrtaren ligjore Gzona Rama Demaj, në konfliktin administrativ të paditësit Newco M. LLC, me adresë rr. “.....”, pnr., F., kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datë 04.11.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit Newco M.F. LLC , me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër 194/2017, i datës 21.08.2017 i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektoratit të Punës.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi ka parashtruar padi me dt.10.10.2017 dhe për të vendosur lidhur me të është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor me dt 04.11.2020, e cila është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prezencën e përfaqësuesit të palës paditëse av.Qëndrim Zogaj dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt (provë: fletëkthesa e dt.19.10.2020).

Përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë precizimin e padisë në atë mënyrë që i ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë ndërsa vendimin e të paditurës me nr.194/2017 të datës 21.08.2017 ta ndryshoj ashtu që të aprovoj ankesën e paditësit dhe të shfuqizoj vendimin për shqiptimin e gjobës me nr.166/2017 të datës 29.06.2017, ose që gjykata të marr vendim me të cilin e anulon vendimin e shkallës së dytë nr.194/2017 dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura. Më tutje ka theksuar se qëndron në tërësi si në deklaratimet në padi, duke shtuar se me vendimin nr.166/2017 të datës 29.06.2017 gjoba i është shqiptuar paditësit vetëm për shkelje të nenit 56 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 , 2.4 dhe 2.5 të Ligjit të Punës dhe jo për shkeljet për shkak të mos zbatimit të detyrimeve lidhur me orarin e punës. Rrjedhimisht as kjo shkelje që ka konstatuar e paditura nuk qëndron për disa arsye: Ligji i punës me dispozitën e nenit 56 par 4 lejon mundësinë që punëdhënësi në marrëveshje me të punësuarit për punët jashtë orarit në vend të kompensimit shtesë të punësuarit të kompensohen me ditë pushimi, dhe këtë e ka bërë paditësi ashtu që në marrëveshje me të punësuarit për orët shtesë dhe për punën gjatë festave zyrtare i ka kompensuar me ditë pushimi dhe për këtë gjenden provat në shkresat e lëndës, siç janë: vendimet për kompensim të orëve shtesë në pushim, pastaj deklaratat e të punësuarve ku të njëjtët pajtohen që për orët shtesë të bëhet kompensimi përmes pushimit, e që nënkupton se paditësi nuk ka shkelur këtë detyrim ligjor siç pretendon e paditura. Më tutje vendimi i shkallës së dytë i të paditurës është marr me shkelje të Ligjit për Procedurën

Administrative pasi që në këtë vendim nuk thuhet as edhe një fjali e vetme se përse provat e prezantuara nga paditësi nuk janë marre për bazë gjatë shqyrtimit të ankesës. LPA kërkon që arsyetimi i vendimit të përmbaje arsyet se cilat fakte janë shqyrtuar dhe arsyetimin se përse nuk janë të bazuara pretendimet ankimore. Vendimi i shkallës së dytë i të paditurës është kopje pothuajse identike e vendimit të shkallës së parë andaj si i tillë i njëjti duhet të anulohet si i paligjshëm. Po ashtu konsiderojmë që gjoba e shqiptuar përveç se është shqiptuar në kundërshtim me gjendjen faktike e njëjta është edhe arbitrare.

E paditura nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa nëpërmes përgjigjes në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datën 29.11.2019 ka theksuar: komisioni i organit të shkallës së dytë ka vërtetuar se inspektorati i punës drejtë e ka konstatuar gjendjen faktike, ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore e po ashtu drejtë ka vlerësuar edhe të gjitha rrethanat që kanë sjellur deri te marrja e vendimit anulimin e të cilit paditësi e kërkon pa asnjë bazë ligjore. Mbi këtë bazë i propozojë gjykatës që të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin e të paditurës me nr.194/17 të datës 21.08.2017.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 04.11.2020, ka administruar këto prova: Vendimi i MPMS-IP me nr. prot.194/2017 i dt.21.08.2017; Vendimi i MPMS-IP Ferizaj me nr.prot. 166/2017 i dt.29.06.2017; Raport zyrtar i përpiluar me datë 15.06.2017; Deklaratat e punëtorëve: M. Xh., I. S., A. B., Rr. V.; Aktvendim për caktimin e punëtorëve që ti kryejn punët dhe detyrat e punës për perioidën kohore prej orës 22:00 deri në ora 06:00 të ditës se nesërme i përpiluar me datë 02.10.2016 në emër të punëtorit I. S., M. Xh., Rr. V., A. B.; Aktvendimi për kompensimin e punës gjatë festës zyrtare me nr.124/2016 i datës 12.02.2016, me nr.124/16 i dt.04.07.2016, me nr.124/16 i dt.09.09.2016, me nr.124/17 i dt.15.02.2017, të gjitha të lëshuara në emër të punëtorit I.S.; Aktvendimi për kompensimin e punës gjatë festave zyrtare me nr.133/16 i datës 12.02.2016, me nr.133/16 i dt.04.07.2016, nr.133/16 i dt.09.09.2016, nr.133/17 i dt.05.02.2017, të gjitha të lëshuara në emër të punëtorit A. B.; Aktvendimi për kompensimin e punës gjatë festës zyrtare nr.07/16 i datës 12.02.2016, nr.07/16 i dt.04.07.2016, nr.07/16 i dt.09.09.2016, nr.07/17 i dt.15.02.2017, të gjitha të lëshuara në emër të punëtorit M. Xh.; Aktvendimi për kompensimin e punës gjatë festës zyrtare nr. 50/16 i dt.12.02.2016, nr.50/16 i dt 04.07.2016, nr.50/16 i dt.09.09.2016, nr.50/17 i dt.15.02.2017, në emër të punëtorit Rr. V.; Foto të njoftimeve të shpallura nga paditësi; Ankesa me nr. prot. 29/17 e dt.07.07.2017; Kërkesa mbi shqyrtimin e ankesës e dt.11.08.2017; Raporti zyrtar me nr.prot.144/17 i dt.24.05.2017 si dhe Certifikata e regjistrimit të biznesit në emërin e paditësit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me vendimin e organit të shkallës së parë, të të paditurës MPMS- Inspektorati i Punës në Ferizaj, me numër 166/2017, të datës 29.06.2017, këtu paditësit “Neëco M.F.j LLC”, i ka shqiptuar gjobën në shumë prej 5, 000 (pesëmijë) euro për shkak të shkeljes së nenit 56 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit të Punës 03/L-212.

Me vendimin e organit të shkallës së dytë, MPMS-së-IP-së Nr.194/2017 të datës 21.08.2017, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar dhe është vërtetuar vendimi i Inspektoriatit të Punës me Nr.166/2017.

I pa kënaqur me vendimin e të paditurës nr.194/2017, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i'u referua Ligjit për Punë Nr.03/L-212, dhe atë nenit 27 paragrafi 1 i cili ka përcaktuar: “Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate”. Dhe nenit 56 Paga shitesë në paragrafet 1, 2, 3, 4 dhe 5 të të cilit është përcaktuar:

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, ontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

3. Paga shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra-tjetrën.

4. I punësuarit mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi;

5. Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të kompanisë.

Përvec referimeve ligjore si më lartë, Gjykata shqyrtoi dhe mori për bazë edhe provat e administruara, dhe kështu nga Raporti zyrtar i inspektimit me numër nr.prot.144/17 i datës 24.05.2017, gjykata gjeti se inspektorët te paditësja kishin konstatuar një varg shkeljesh nga mardhënia e punës, siguria dhe shëndeti në punë. Inspektorët e punës: H. H. dhe V. Zh. konkretisht për shkeljet e konstatuar nga mardhënia e punës kishin obliguar paditësinë që në afat prej 7 dite ti eliminoj të metat e konstatuar, ku me këtë rast ishte kërkuar ndër të tjera të prezantohet: evidenca e orëve të punës gjatë festave zyrtare, orëve të punës gjatë natës dhe vikendit dhe dëshmitë e kompensimit të këtyre orëve, dhe po ashtu ishte njoftuar paditësi se mos eliminimi i tyre është i sanksionur me Ligjin e Punës dhe Udhëzimin Administrativ nr.07/2012.

Nga Raporti Zyrtar i përpiluar me datë 15.06.2017, i kryer sërish nga inspektorët H. H. dhe V. Zh., vërehet se ishin eliminuar disa nga konstatimet e shkeljëve sipas raportit të datës 24.05.2017, megjithatë përsëri ishte konstatuar se punëdhënësi në këtë rast paditësi nuk kishte prezantuar evidencë për orët e punës gjatë natës dhe festave zyrtare, duke qenë se biznesi punonte në tri ndrrime, si dhe nuk kishte prezantuar dëshmi të pagesës për këto orë pune.

Do të thotë nga raporti i inspektimit të datës 24.05.2017, datës 15.06.2017 e po ashtu edhe nga vendimet e të paditurës nr.166/17 dhe 194/17 nuk bëhet e ditur në asnjë moment se paditësja kishte prezantuar para inspektorëve apo te e paditura provat si të prezantuara në gjykatë, dhe atë: deklaratat e punëtorëve, Aktvendimet për caktimin e punëtorëve që ti kryejn punët dhe detyrat e punës në periodën kohore prej orës 22:00 deri në ora 06:00, Aktvendimet për Kompensimin e punës gjatë festës zyrtare, e sipas të cilave gjoja punëtorët pajtohen që për punën e kryer natën dhe gjatë festave zyrtare në vend të pagesës shtesë si të përcaktuar në nenin 56 paragrafi 2 të Ligjit të punës të kompensohen me ditë pushimi sic është përcaktuar me nenin 56 paragrafi 4 të Ligjit të Punës. Prandaj duke konstatuar se të njëjtat prova janë prezentuar nga paditësi vetëm me rastin e parashtrimit të padisë gjykata nuk i mori për bazë dhe nuk i konsideroi të qena në momentin e konstatimit të shkeljës si Ligjit të punës.

Prandaj, duke pasur parasysh obligimin ligjor të përcaktuar në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Ligjit të punës, sipas të cilit punëdhënësi këtu paditësi ka qenë i detyruar të kompensoj me pagë shtesë për punët e kryer nga punëtorët gjatë natës, ditëve të festave zyrtare, nga provat e cekura si më lartë kjo gjykatë konstatoj se organi i paditur drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore. Prandaj me të drejtë e paditura kishte refuzuar ankesën e paditësit dhe kishte lënë në fuqi vendimin me nr.166/17, me të cilin paditësi ishte gjobitur për shkak të shkeljeve të përmenduar si më lartë në shumë prej 5000 euro, bazuar në dispozitat e nenit 92 të Ligjit të

punës, me të cilin ishin përcaktuar gjobat në shumë prej 100 deri në 10000 euro për shkeljet e Ligjit të punës dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës, i cili në nenin 7, paragrafi 2 nënparagrafi 2.25 ka përcaktuar gjobën prej 100 deri në 7.000 €, për çdo shkelës të dispozitës së nenit 56 të Ligjit të Punës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna si në padi dhe seancën e shqyrtimit kryesor, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pabazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin me ndiku që kjo gjykatë të mund të vërtetoj një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, nga e paditura, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, drejtë janë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe ligjit material.

Vendimin që secila palë të i bart shpenzimet e veta, Gjykatë e mbështet në dispozitën e nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1707/17, datë 04.11.2020

Zyrtarja ligjore
Gzona Rama Demaj

G j y q t a r j a
Vjollca Limani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.